



**Republika e Shqipërisë
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

RAPORT

Për

Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

1 Janar – 31 Dhjetor

Viti 2018

TIRANË, SHKURT 2019


Përmbajtja

I. VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KQZ-SË	3
1.2 Administrimi i dokumentacionit zgjedhor	5
1.3 Raportet financiare vjetore të partive politike për vitin 2018	5
1.4 Auditimi i fondeve të partive politike për vitin kalendarik 2017.....	6
1.5 Buxheti i KQZ-së për vitin 2018.....	6
1.6 Hapja e kutive të votimit dhe e kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.06.2017, zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Kavajë të datës 25.06.2017 dhe zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Kolonjë të datës 20.11.2016.....	7
II- PLOTËSIMI I VAKANCAVE TË KRIJUARA NGA KUVENDI I SHQIPËRISË PËR VITIN 2018	8
III. ADMINISTRIMINI ZGJEDHOR, VËSHTRIM MBI TË DHËNAT E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE, TRAJNIME JASHTË PERIUDHËS ZGJEDHORE PËR PERSONA TË INTERESUAR	9
3.1 Trajnimet për administrim zgjedhor, të përgjithshme dhe për funksione të veçanta, për të interesuarit gjatë vitit 2018.....	13
3.2 Organizimi i programeve për edukimin zgjedhor të shtetasve	14
IV. VEPRIMTARIA E KQZ-SË PËR PËRGATITJEN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019	15
4.1 Plani Orientues i Veprimeve.....	15
4.2 Aktet e miratuara në KQZ, gjatë vitit 2018, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.	16
V. AKTIVITETE ME PARTNERË NDËRKOMBËTARË	17
5.1 Grupi Ndërkombëtarë i Punës për Zgjedhjet (EWG).....	17
5.2 Konferenca e 27-të vjetore e Shoqatë Europiane të Zyrtarëve Zgjedhor (ACEEEO)	19
VI - VERIFIKIMI I VETËDEKLARIMEVE TË FUNKSIONARËVE (DEKRIMINALIZIMI)	19

I. VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KQZ-SË

1.1 Burimet njerëzore

Administrata e KQZ-së, e organizuar sipas strukturës dhe organigramës të miratuar me Vendimin e KQZ-së nr.110 datë 12.09.2002 "Për miratimin e strukturës, organikën dhe numrin e punonjësve të administratës së KQZ-së", ndryshuar me vendimin nr.168, datë 24.04.2017, ka 71 pozicione pune, 45 pozicione janë pjesë e shërbimit civil dhe 26 punonjës mbështetës. Numri i punonjësve gra është 39 ose rreth 54%.



Strukturat e administratës së KQZ-së kryejnë detyra organizative dhe teknike, për procesin parazgjedhor ashtu edhe atë zgjedhor. Detyrat, përgjegjësitë dhe objektivat kryesore të punës janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Administratës së KQZ-së si dhe në formularët e përshkrimit të punës.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, që synon zhvillimin e një shërbimi civil profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë, gjatë vitit 2018 u mbikëqyr nga "Komisioneri për mbikëqyrjen e Shërbimit Civil" për periudhën nga hyrja në fuqi e ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" deri në Maj të 2018.

Raporti përfundimtar i Komisionerit, vlerëson se:

- Në përmbajtjen e strukturës organizative të institucionit është ruajtur një raport i drejtë midis pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, nga ato që kryejnë shërbime mbështetëse, apo që bëjnë pjesë tek njësitë publike direkte të shërbimit.
- Procedura e ndjekur për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të pozicioneve të punës, vlerësimit në punë, administrimit të dosjeve të personelit, procedurat e liritimit



nga shërbimi civil për shkak të mbushjes së moshës së pensionit apo dorëheqjes janë kryer në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.

- Procedurat e konkurimit, nëpërmjet pranimi në shërbim civil, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, procedurat e tranferimit të përkohshëm dhe të përhershëm, procedurën e pezullimit, janë zhvilluar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe në zbatim të tij.

Gjatë 2018:

- Janë zhvilluar në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor të nëpunësit civil, procedurat për:
 - Pranimin në shërbimin civil për 5 pozicione të kategorisë ekzekutive (specialistë), të cilët kanë përmbyllur me sukses trajnimin e detyrueshëm pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike;
 - Emërimin në kategori e ulët drejtuese për 3 (tre) pozicione "Përgjegjës Sektori", për dy raste me procedurën e ngritjes në detyrë, dhe për një rast procedura e rekrutimit jashtë shërbimit civil, sipas nenit 26, pika 4, të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.
 - Lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë për një pozicion pune të kategorisë së mesme drejtuese (Drejtor drejtorie), të cilat kanë përfunduar pa kandidat të përzgjedhur, dhe ky pozicion është publikuar përsëri.
 - Lirimin nga shërbimi civil të 2 (dy) nëpunësve për shkak të mbushjes së moshës së pensionit.
- Janë rekrutuar në zbatim të "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar:
 - Punonjës mbështetës me kontrata pune paafat të caktuar për 4 (katër) pozicione pune: Sekretare 3 (tre) dhe 1 (një) recepsionist;
 - Punonjës me kohë jo të plotë pune 50 (pesëdhjetë), nga të cilët 15 specialistë, 5 operatorë dhe 35 punëtorë, bazuar në vendimin e KQZ nr.16, datë 12.03.2018 "Për miratimin e mënyrës së asgjësimit të fletëve të votimit, administrimin e dokumentacionit zgjedhor dhe shpenzimeve buxhetore për hapjen e kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore të përdorura për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25.06.2017".
 - Punonjës me kohë jo të plotë pune 5 (pesë) operatorë, për zbatim të marrëveshjes së nënshkruar mes KQZ dhe DPA për përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të KQZ-së të dorëzuara për ruajtje të përhershme pranë DPA-së, dhe VKM nr.60, datë 31.1.2018 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes vendore".
- Nga trajnimet e organizuara në bashkëpunim me organizma ndërkombëtarë, kanë përfutur 61 nëpunës civilë të administratës së KQZ-së:
 - "Transparenca për Autoritetet Publike", 40 nëpunës të niveleve të ndryshme;



- "Planifikimi i punës për Zgjedhjet Vendore 2019", 12 nëpunës të niveleve të ndryshme;
- "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", 2 nëpunës të niveleve të mësem drejtues;
- "Roli i Trupave të Menaxhimit Zgjedhor, në promovimin e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjen politike të grave", 2 nëpunës (Kore e Jugut);
- "Transparenca e Financimit të Partive Politike në Shqipëri", 2 nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (Mbretëria e Bashkuar).
- "Për zbatimin e Strategjisë Kombëtare Antikorrupsion 2018-2020", 2 nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (Austri).

Në përgjigje të kërkesës së ASPA me objekt "Për vlerësimin e nevojave për trajnim brenda dhe jashtë vendit", është krijuar rregjistri me tema trajnimi për të cilat administrata e KQZ shfaqti interes, të natyrës së përgjithshme, apo specifike si dhe trajnime për gjuhët e huaja, sipas fushës së veprimtarisë. Realizimi i këtyre trajnimeve nga ASPA do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e karrierës, motivimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve nëpunësve.

1.2 Administrimi i dokumentacionit zgjedhor

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.16, datë 12.03.2018, vendosi hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 25.06.2017, dhe zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, Dibër, Kolonjë dhe Kavajë. I gjithë materiali zgjedhor është përpunuar, janë numërtuar 262.276 fletë të vendosura në 408 kuti, për t'u dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, me ruajtje RHK. Në zbatim të Kodit Zgjedhor, që përcakton se KQZ mban një kopje të dokumentacionit zgjedhor, dokumentacioni është skanuar për t'u bërë pjesë e arkivës elektronike të KQZ.

KQZ kërkon vëmendje nga legjislatori, sa i përket klasifikimit të formularëve të dekriminalizimit, si dokumentacion zgjedhor apo administrativ. Ky përcaktim, do të qartësonte mënyrën, vendin dhe kohën e ruajtjes të këtij dokumentacioni voluminoz.

1.3 Raportet financiare vjetore të partive politike për vitin 2018

Në zbatim të Ligjit nr.10374, datë 10.02.2011 "Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, partitë politike dorëzojnë në KQZ raportet financiare, sipas modelit të raportit financiar miratuar me vendim nga KQZ.

Data 31 mars e vitit pasardhës, është afati i dorëzimit të raportit financiar, përcaktuar nga KQZ me vendimin nr. 14, datë 23.11.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.3, datë 18.01.2012 "Për miratimin e rregullave për formatet e standardizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar të ekspertëve kontabël".

Për vitin kalendarik 2017, nga 128 parti politike të regjistruara në Gjykatën e Rrethit



Gjyqësor Tiranë, kanë dorëzuar raportet financiare vjetore në KQZ, vetëm 44 parti politike. Raportet financiare të partive politike për vitin 2017 janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, ne linkun: <http://cec.org.al/raportet-vjetore-financiare-te-partive-politike/>

1.4 Auditimi i fondeve të partive politike për vitin kalendarik 2017

KQZ me vendimin nr.23, datë 27.04.2018 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për vitin kalendarik 2017", përzgjedhi me short dhe emëroi 23 ekspertë kontabël për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga 113 parti politike gjatë vitit 2017. (15 parti të regjistruara në gjykatë nuk u përfshinë në shortin për përzgjedhjen e ekspertëve, pasi nuk kishin adresë dhe kryetar të deklaruar në regjistrin e partive politike).

KQZ administroi raportet e auditimit të ekspertëve kontabël, dhe përgatiti materialin mbi bazën e opinionit të shprehur prej tyre. Në përfundim të procesit të verifikimit të raporteve të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin 2017, rezultoi se nga 113 parti politike të cilat duhet të auditoheshin:

- 62 parti politike, nuk u arritën të kontaktoheshin nga ekspertët kontabël për shkak të pasaktësisë së adresave të deklaruara nga keto parti politike prane Gjyqësor Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Për 21 parti politike, ka deklaratë të kryetarit të partisë ose të autorizuarit të tij se partia nuk ka përfituar dhe shpenzuar fonde për vitin 2017.
- Për 30 parti politike, ekspertët kontabël kanë paraqitur një raport të rregullt auditimi, për të gjitha këto parti politike, eksperti nuk ka vërejtje për mënyrën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

Nga auditimi vjetor rezultoi se asnjë prej partive politike të audituara nuk kishin shkelur dispozitat e Ligjit 8580, datë 15.02.2000 "Për partitë politike".

Raportet e auditimit janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, ne linkun: http://cec.org.al/raportet-e-auditimit-per-fondet-vjetore-te-partive-politike/#tabs_desc_29854_2

1.5 Buxheti i KQZ-së për vitin 2018

Me ligjin nr.109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018", Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i janë caktuar fonde në programin Planifikim, Menaxhim dhe Administrim, për vitin në shumën 128.300.000 lekë. Detajimi i zërave të buxhetit është bërë në funksion të përmbushjes së detyrave të strukturave të administratës të KQZ-së, bazuar në realizimin e buxhetit gjatë viteve të kaluara, si për bazë materiale dhe shërbime të ndryshme: shpenzime për paga 78 milionë lekë, shpenzime për sigurime 14.3 milionë lekë, shpenzime për mallra dhe shërbime 32.46 milionë lekë, transfertat korrente të huaja 300 mijë lekë, transfertat për buxhetet familjare dhe individët 240 mijë lekë, investime 3 milionë lekë.



Me VKM nr.407, date 04.07.2018 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2018, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve", KQZ-së ju shtua fondi prej 5 milionë lekë për përballimin e shpenzimeve për hapjen e kutive të votimit dhe të kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.06.2017, në zgjedhjet e pjeshme për Kryetarin e Bashkisë Kolonjë datë 20.11.2016 si edhe në zgjedhjet e pjeshme për Kryetarin e Bashkisë Kavajë datë 25.06.2017.

Fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit u përdorën me efikasitet në përputhje me legjislacionin në fuqi për manaxhimin e fondeve publike.

1.6 Hapja e kutive të votimit dhe e kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.06.2017, zgjedhjet e pjeshme për Kryetarin e Bashkisë Kavajë të datës 25.06.2017 dhe zgjedhjet e pjeshme për Kryetarin e Bashkisë Kolonjë të datës 20.11.2016.

Në zbatim të vendimit të KQZ-së nr.16, datë 12.03.2018 "Për miratimin e mënyrës së asgjësimit të fletëve të votimit, administrimi i dokumentacionit zgjedhor dhe shpenzimeve buxhetore për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.06.2017, zgjedhjet e pjeshme për Kryetarin e Bashkisë Kavajë të datës 25.06.2017 dhe zgjedhjet e pjeshme për Kryetarin e Bashkisë Kolonjë, të datës 20.11.2016", u kryen procedurat ligjore për hapjen e 5 362 kutive të votimit, 5362 kutive të materialeve zgjedhore, administrimin e dokumentacionit zgjedhor si dhe asgjësimit të fletëve të votimit. Punonjësit e angazhuar në këtë proces, u trajnuan për kryerjen korrekte të proceseve të punës, metodologjinë për evidentimin dhe selektimin e dokumentacionit që arkivohet, për mënyrën e grumbullimit dhe sistemimit të materialeve të ripërdorshme.

Hapja e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, u bazua në kriterin e seleksionimit dhe administrimin e dokumentacionit zgjedhor të parashikuar në nenin 178, pika 6 të Kodit Zgjedhor, i cili do t'i dërgohet Arkivit Qendror të Shtetit, seleksionimin e materialeve që mund të ripërdoren, si dhe zbatimin e mënyrës së asgjësimit të fletëve të votimit bazuar në Vendimin e KQZ-së sipërcituar.

Neni 178, pika 6 e Kodit Zgjedhor përcakton se "të gjitha fletët e votimit asgjësohen sipas mënyrës së përcaktuar nga KQZ". Asgjësimi i fletëve të votimit, u krye me riciklim të letrës, sikundër përcaktuar në vendimin e KQZ-së nr. 16, datë 12.03.2019.

Bazuar në nenin 178, pika 6, të Kodit Zgjedhor, dhe procedurës së përcaktuar nga KQZ me vendimin nr.16 datë 12.03.2018, u seleksionua dhe u krye verifikimi paraprak i dokumentacionit që dërgohet në Arkivin Qendror të Shtetit:



1. Lista e Zgjedhësve
2. Regjistri i posaçëm i zgjedhësve
3. Libri i protokollit KQV-së
4. Procesverbal PV-KQV-07
5. Procesverbal PV-KQV-08

Për çdo KZAZ, u identifikuan dhe rregjistruan qendrat e votimit, u krye seleksionimi dhe rregjistrimin e dokumentacionit përkatës në procesverbalin e KZAZ-së respektive. Dokumentacioni është sjellë rregullisht në Zyrën e Arkivës në KQZ, në bazë qarku/ZAZ/QV, ku është realizuar një verifikim dhe organizim i dytë i tij dhe më pas është regjistruar në bazën e të dhënave.

Numërtimi i dokumentacionit është bërë për çdo fletë të: listës së zgjedhësve, regjistrin të posaçëm, librit të protokollit, PV-07, PV-08, si pjesë e sistemit të dokumentimit të procesit të administrimit të dokumentacionit. I gjithë dokumentacioni është administruar në dosje më vete, duke identifikuar numrin e QV-së, ZAZ-së, qarkun që i korrespondon, numrin e fletëve të administruara dhe afatin e ruajtjes. Më pas dosjet janë organizuar dhe sistemuar në mënyrën e kërkuar nga Arkivi i Shtetit.

II- PLOTËSIMI I VAKANCAVE TË KRIJUARA NGA KUVENDI I SHQIPËRISË PËR VITIN 2018

Për plotësimin e vakancave të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim, në zbatim të Nenit 164 të Kodit Zgjedhor. Ky nen përcakton, se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës, dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës, në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Gjatë vitit 2018, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë 4 (katër) zëvendësime vakancash të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë, për shkak të ndërprerjes së mandatit të deputetëve si më poshtë:

1. Me vendimin nr.05, datë 15.01.2018, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës, në listën shumemërore të Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet, Qarku Elbasan, z. Dritan Bici, për shkak të heqjes së mandatit të deputetit z. Aqif Rakipi, në kuadër të plotësimit të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë për këtë qark.
2. Me vendimin nr.06, datë 15.01.2018, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës, në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Berat, znj.Silva Caka, për shkak të heqjes



së mandatit të deputetit z. Gledion Rehovica, në kuadër të plotësimit të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë për këtë qark.

3. Me vendimin nr.10, datë 19.02.2018, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës, në listën shumemërore të Partisë Demokratike, Qarku Berat, z. Astrit Veliaj, për shkak të heqjes dorë nga mandati të deputetit të z. Eduard Halimi, në kuadër të plotësimit të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë për këtë qark.
4. Me vendimin nr.24, datë 19.02.2018, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës, në listën shumemërore të Partisë Socialiste, Qarku Tiranë, z. Spartak Braho, për shkak të heqjes dorë nga mandati të deputetit të z. Saimir Tahiri, në kuadër të plotësimit të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë për këtë qark.

III. ADMINISTRIMINI ZGJEDHOR, VËSHTRIM MBI TË DHËNAT E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE, TRAJNIME JASHTË PERIUDHËS ZGJEDHORE PËR PERSONA TË INTERESUAR

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, për shqyrtimin e bazës së të dhënave të administratës zgjedhore dhe përpunuar konkluzionet duke e trajtuar çështjen nga këndvështrimi historik i sjelljes politike të subjekteve zgjedhore gjatë proceseve zgjedhore, evidentohet:

- Zëvendësimet e anëtarëve të KZAZ-ve në vijimësi, në numrin më të madh në muajin e zgjedhjeve, madje deri në ditën e zgjedhjeve:

Zgjedhje për Kuvendin 2009: nga 528 anëtarë dhe sekretarë të KZAZ, me kërkesë të partive politike janë zëvendësuar 146 komisionerë ose 28%.


Zgjedhjet vendore 8 maj 2011: nga 528 anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve me kërkesë të partive politike janë zëvendësuar 140 komisionerë ose 26 % .

Zgjedhje për Kuvendin 2013: nga 712 anëtarë dhe sekretarë të KZAZ, janë zëvendësuar 253 komisionerë, nga këta 4 gjatë ditës së zgjedhjeve, në përqindje 35.5%.

Zgjedhjet vendore 2015: nga 720 anëtarë dhe sekretarë të KZAZ u zëvendësuan 271 komisionerë ose 37.6%.

Zgjedhje për Kuvendin 2017: nga 720 anëtarë dhe sekretarë të KZAZ u zëvendësuan 131 ose 18% komisionerë. Ulja e numrit të zëvendësime ndikohet nga fakti se partitë e opozitës parlamentare i paraqitën kandidaturat për anëtarë të KZAZ-ve në fillim të muajit qershor.





Kjo sjellje e partive politike, në raport me të drejtat e gjëra që Kodi Zgjedhor i njej sa i përket zëvendësimit të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve:


- ndikon në opinionin publik për paanshmërinë, hedh dyshime për pavarësinë e administratës zgjedhore;
 - cënon profesionalizmin e komisionerëve, zëvendësimet ndodhin pasi KQZ ka realizuar trajnimin e KZAZ-ve;
 - cënon kolegjalitetin e funksionimit të KZAZ-ve, edhe për shkak të mosnjohjes së procedurave nga anëtarët e pa trajnuar;
 - cënon njëtrajtshmërinë e procesit, veçanërisht numërimit të votave, shkakton vonesa në nxjerrjen e tabelave të rezultateve, për shkak të zëvendësimeve të sekretarëve, të cilët kryejnë detyra shumë të rëndësishme në proces.
- Emërimet e komisionerëve të nivelit të III-të (KQV), në tejkallim të skajshëm të afatit ligjor për shkak të propozimeve të vonuara të partive politike, sjellje e dëshmuar në të gjitha proceset zgjedhore, cënon rëndë mirë administrimin e procesit zgjedhor:
 - Mbi 50 % e anëtarëve të KQV ushtrojnë detyrën pa u trajnuar;
 - Emërimet e vonuara cënojnë në mënyrë thelbësore skemën e trajnimit e planifikuar nga KQZ. Vetëm në ditët e fundit ka pjesëmarrje të komisionerëve në sesionet e trajnimit, duke shkaktuar tejkallim të numrit të parashikuar për sesion, reduktim të interaktivitetit për diskutim dhe qartësim të procedurave.
 - Mosnjohja e procedurave përbën shkak për shkelje të ligjit, debate mes komisionerëve, vonesa në hapjen e qendrave të votimit, vonesa në fillimin e votimit, madje edhe në pezullim të votimit për të korrigjuar parregullsitë e shkaktuara në administrimin e materialit zgjedhor nga komisionerë të patrajnuar.

Zgjedhje për Kuvendin 2013, propozimet për anëtarët e KQV megjithëse jo në afatin ligjor në të gjitha KZAZ, rezultuan fiktive pasi para datës së zgjedhjeve u zëvendësuan pothuaj totalisht me propozime të reja, në shkelje të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor.

Zgjedhje vendore 2015, vetëm 18 KZAZ emëruan anëtarët e KQV në afatin ligjor, 72 KZAZ jashtë afatit, nga të cilat 28 KZAZ vetëm një ditë para zgjedhjeve.

Zgjedhje për Kuvendin 2017, vetëm 21 KZAZ kishin emëruar anëtarët e KQV-ve në afatin ligjor. KZAZ e tjera, në tejkalim të afatit ligjor, dhe 13 KZAZ I emëruan anëtarët e KQV vetëm një ditë para datës së zgjedhjeve.


Tabela më poshtë jep të dhëna për numrin e KZAZ-ve, sipas datës kur kanë disponuar me vendime emërimin e komisionerëve të qendrave të votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Qershor 2017.



- Mosrepektimi i Kodit Zgjedhor nga partitë politike për paraqitjen e propozimeve për anëtarë të GNV-ve, e për pasojë emërimet e realizohen përgjithësisht para fillimit të procesit të numërimit por edhe gjatë procesit të numërimit:
 - trajnimi i anëtarëve të GNV kryhet përgjithësisht para fillimit të procesit të numërimit, në VNV, ndërkohë që merren në dorëzim materialet zgjedhore, në kohë të kufizuar dhe atmosferë jo të qetë.
 - çënohet profesionalizmi i numëruesve, duke sjellë problematika në proces, të cilat përbëjnë shkak edhe për debate, situata dhe zgjatje të panevojshme të tij.

Zgjedhje vendore 2015: Pothuaj të gjitha KZAZ-të i emëruan GNV vetëm para fillimit të procesit të numërimit të votave, dhe 23 KZAZ vijuan emërimet edhe të nesërmen e ditës së votimit.

Zgjedhje për Kuvend 2017: Në afatin ligjor për emërimin e GNV, data 15 qershor 2017, vetëm 23 KZAZ kishin disponuar me vendim emërimin e anëtarëve të GNV-ve. Të dhënat e grafikut më poshtë, dëshojnë vonesat e skajshme të partive politike për paraqitjen e propozimeve për anëtarë të GNV.



- Paraqitja e kandidaturave me eksperiencë zgjedhore

Partitë politike propozojnë kandidatura me eksperiencë zgjedhore kryesisht për nivelin e dytë të administratës zgjedhore. Në nivelin e III-të të administratës zgjedhore, përqindja e kandidaturave me eksperiencë të mëparshme zgjedhore është e reduktuar. Duke u vetëmjaftuar me eksperiencën zgjedhore, partitë politike dhe vetë kandidatët e propozuar prej tyre për anëtarë të KZAZ-ve, tregojnë sjellje neglizhente ndaj trajnimit të KQZ-së, duke cënuar skemën e trajnimit dhe profesionalizmin e KZAZ-ve.


Angazhimi i komisionerëve zgjedhorë me eksperiencë zgjedhore, padyshim është pozitiv sa i përket qëndrueshmërisë së njohjes së procedurave nga administrata zgjedhore. Por, për shkak të ndryshimeve ligjore, faktit se komisionet zgjedhore ngrihen dhe funksionojnë për periudhë të shkurtër kohe çdo dy vjet, eksperiencë zgjedhore nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme për njohjen e mirë të procedurave. Eksperiencë ka dëshmuar se komisionerë me eksperiencë kanë gabuar në kryerjen e procedurave nga më klasiket. Psh në zgjedhjet 2017, një KZAZ me 6 anëtarë me eksperiencë zgjedhore, për shpërndarjen e materialeve zgjedhore në gjysmën e KQV-ve kreu procedurën e "përzgjedhjes rastësore" të vulës së KQV-së në vend të asaj të Kryetarit të KQV-së. Ky gabim solli pështjellim dhe vonesa në shpërndarjen e materialeve zgjedhore për KQV-të.

Zgjedhjet vendore 2015, nga 720 anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, 208 prej tyre ishin me eksperiencë të mëparshme zgjedhore.

Zgjedhjet për Kuvendin 2017, nga 720 anëtarë të KZAZ-ve, 286 prej tyre (ose 39%) kishin eksperiencë si anëtarë të KZAZ-ve në zgjedhjet pararendëse.

- Përfaqësimi gjinor në administratën zgjedhore

Në komisionet e nivelit të dytë (KZAZ), për shkak të kuotës gjinore të kërkuar nga Kodi Zgjedhor, por edhe për qasje të partive politike që nuk kanë detyrim për kuotë gjinore në propozime, përfaqësimi i grave shënon tendencë në rritje. Partitë politike që kanë detyrimin e kuotës gjinore në propozimet për anëtarë të KZAZ-ve, e respektojnë atë në propozimet e para, edhe në zëvendësimet në vijim.



Megjithatë, kuota gjinore sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor për anëtarët e KZAZ-ve, nuk realizon përfaqësimin 30% të grave në çdo KZAZ, si dhe të përfaqësuarat në përqindje të ulët në pozicionet drejtuese.

Zgjedhje vendore 2015: në 58 KZAZ përfaqësimi i grave ishte nën 30%.

Zgjedhje për Kuvend 2017: Në 57 KZAZ përfaqësimi i grave ishte nën kuotën 30%.



Nga 720 anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, 219 ose 30.4% ishin gra, nga të cilat 23 ushtruan detyrën e Kryetares, 18 të Zëvendëskryetares, 24 të sekretares.

Për nivelin e III-të të administratës zgjedhore, komisionet e qendrave të votimit dhe grupet e numërimit të votave, mungesa e kuotës gjinore për përbërjen e tyre, evidenton stereotipe gjinore në sjelljen e partive politike:

Zgjedhje vendore 2015: 51% e KQV në rang vendi nuk kishin asnjë grua në përbërjen e tyre, 40 % e KQV kishin përfaqësim të grave nën 30%, dhe vetëm 9% e KQV kishin përfaqësim të grave mbi 30 %.

Zgjedhje për Kuvend 2017: Nga 37 534 anëtarë të komisioneve të qendrave të votimit, 5 814 ose 15.5% e tyre ishin gra.

Nga 3464 anëtarë të 866 Grupeve të Numërimit të Votave, 422 ose 12.2 % e tyre ishin gra

3.1 Trajnimet për administrim zgjedhor, të përgjithshme dhe për funksione të veçanta, për të interesuarit gjatë vitit 2018

KQZ, në fokus të trajnimeve përgjatë vitit 2018 ka patur zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, për t'i kushtuar rëndësi të posaçme trajtimit të çështjeve të shitblerjes së votës, korrupsionit të administratës zgjedhore, mashtrimit zgjedhor, abuzimit me burimet shtetërore dhe presioneve mbi zgjedhësit, si dhe ato të lidhura me vendin e punës.

4 000 fletë palosje me informacion të plotë për llojet e veprave penale që çenojnë zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, dhe masën e dënimit për to u shpërndanë në 30 sesione trajnimi të organizuara për informim dhe ndërgjegjësim për këto çështje, me studentët e Universiteteve "Eqerem Çabej" Gjirokastër, "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, "Luigj Gurakuqi" Shkodër, "Ismail Qemali" Vlorë, Universitetin e Tiranës, "Marin Barleti" dhe "Albanian University" Tiranë.

Me qëllim plotësinë e informacionit, dhe lehtësinë e aksesueshmërisë për përdoruesit, fletëpalosjet informative për veprat penale në zgjedhje u hartuan në dy lloje. E para për zgjedhësin (informacion për veprat penale që mund të kryejë zgjedhësi) dhe e dyta për komisionerët zgjedhorë (informacion për veprat penale që mund të kryejnë komisionerët zgjedhorë gjatë ushtrimit të detyrës). Koncepti grafik i fletëpalosjeve u realizua si angazhim dhe kontribut vullnetar i studentëve të Universitetit "Polis", duke i realizuar ato në formë inovative dhe bashkëkohore, me qëllim rritjen e interesit publik për marrjen e informacionit përmes tyre. KQZ e ka konsoliduar praktikën e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve, si një formë për edukimin dhe trajnimin e tyre për çështje zgjedhore. Vendosja e këtyre temave në fokus të trajnimeve të organizuara përgjatë vitit 2018, ishte edhe në zbatim të rekomandimit të Raportit Përfundimtar të OSBE/ODHIR "Nevojiten përpjekje serioze për të trajtuar çështjen e vazhdueshme të blerjes së votës, si nëpërmjet një fushate për ndërgjegjësimin qytetar ashtu edhe nëpërmjet ndjekjes penale, me qëllim forcimin e besimit të procesi zgjedhor".

KQZ, për rritjen e numrit të të interesuarve për të marrë pjesë në trajnimet e organizuara



për administrim zgjedhor përgjatë vitit 2018, krahas hartimit të kalendarit të veprimtarive me shtrirje në të gjithë territorin e vendit, bashkëpunimit me OJF që angazhohen në çështjet e demokracisë dhe të zgjedhjeve, ofroi për të interesuarit edhe mundësinë e aplikimit on-line.

Me qëllim lehtësimin e aksesit për çdo shtetas të interesuar për administrim zgjedhor, u publikua në faqen zyrtare të KQZ-së një rubrikë e veçantë "apliko për trajnim". Kjo rubrikë, informon vizitorët e faqes për:

- organizimin nga KQZ të kurseve për trajnim për administrim zgjedhor në çdo qark/bashki/njësi administrative (pa pagesë), sipas interesit të shfaqur nga shtetasit me vendbanim aty;
- mundësinë që ka çdo shtetas shqiptar që gëzon të drejtën për të qënë zgjedhës, për të aplikuar në formë elektronike, përmes plotësimit të formularit që aksesohet lehtësisht në këtë rubrikë dhe administrohet në KQZ sapo ka përfunduar plotësimi i tij;
- mundësinë për të përzgjedhur për pjesëmarrje një/disja kurse. Modulet e prezantuara ofrojnë njohuri të përgjithshme (për çdo nivel administrimi) dhe brenda nivelit përkatës për funksione të veçanta (kryetar/sekretar/anetar/numërues i parë)
- Spjegim teorik dhe aftësim praktik, që ofrohet në kurset/sesionet e trajnimit për administrim zgjedhor;
- çertifikimin për përfundimin me sukses të kursit/sesionit të trajnimit.

Me studentë dhe pedagogë të universiteteve të ndryshme të vendit janë zhvilluar 40 sesione për administrim zgjedhor në nivelin e II-të (KZAZ) dhe në nivelin e III-të (KQV). Temat e trajnimit për administrim zgjedhor janë trajtuar me modulet përkatëse:

- modul me njohuri të përgjithshme për administrimin zgjedhor;
- 3 module për funksione të veçanta të administrimit zgjedhor (KZAZ, KQV, GNV).

Sikundër eksperiencia e mëparshme ka dëshmuar, efektshmëria e realizimit të programeve të trajnimit në periudhë jashtë zgjedhore, çënohet nga mungesa e dispozitave ligjore për të lidhur trajnimin zgjedhor, testimin dhe certifikimin paraprak nga KQZ-ja, si kusht për t'u emëruar komisioner zgjedhor, shkak i cili kushtëzon interesin për trajnim për administrim zgjedhor në periudhë jashtëzgjedhore. Pritshmëritë për ndryshime të Kodit Zgjedhor, edhe sa i përket administrimit të procesit zgjedhor, objekt i debatit publik gjatë 2018, kanë ndikuar shfaqjen e interesit për trajnim.

Partitë politike, edhe përgjatë këtij viti, dëshmuar mungesë interesi për të orientuar burimet njerëzore, potencialisht komisionerë të nesërm, për të aplikuar/trajnuar/çertifikuar për administrim zgjedhor në periudhë jo zgjedhore.

3.2 Organizimi i programeve për edukimin zgjedhor të shtetasve

Kalendari vjetor i veprimtarive për edukimin zgjedhor të shtetasve synoi:

- shtrirje të veprimtarive në të gjithë territorin e vendit;
- rritje e numrit të pjesëmarrësve/përfituesve;



- forcimin e bashkëpunimit të KQZ-së me aktorë institucionalë me rol procesin zgjedhor, mediat, dhe shoqërinë civile që angazhohen në çështjet e demokracisë dhe të zgjedhjeve;
- ndërgjegjësim qytetar për rëndësinë e zgjedhjeve demokratike, vlerën e votës së lirë, të fshehtë dhe të barabartë.

Janë realizuar 86 sesione edukimi zgjedhor, në 8 qarqe të vendit, në bashkitë Tiranë, Pukë, Shkodër, Elbasan, Belsh, Dibër, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Vlorë, Gjirokastër, Livadhja, Fier, njësitë administrative Zharrëz, Baltëz, Levan.

Mbi 2000 persona kanë marrë pjesë në sesionet e organizuara, të cilët i përkasin target grupeve: studentë, pedagogë, maturantë, mësues, anëtarë të komunitetit rom, gra, punonjës të bashkive, gazetarë etj. Sipas temave të trajtuara:

- 40 sesione edukuese/sesibilizuese për votuesit për herë të parë (maturantë), për sistemin e zgjedhjeve, vlerën e votës, rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje, shprehjen e vullnetit në mënyrë të lirë dhe të pandikuar;
- 40 sesione edukuese për simulimin e procesit të votimit, të drejtat dhe detyrat e zgjedhësit në zgjedhje dhe në qendrën e votimit;
- 4 sesione me nëpunës të Bashkive Pukë, Tiranë, Tropojë, Mat, për detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të bashkisë në zgjedhje;
- 1 sesion me gazetarë për rolin e medias në zgjedhje;
- 2 sesion edukimi&ndërgjegjësimi me gra të të grupeve të ndryshme shoqërore, për rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje, fenomenin negativ të votimit familjar etj.

Zhvillimi i veprimtarive për edukim zgjedhor përgjatë vitit 2018, dëshmoi interesin qytetar për informacion për çështje zgjedhore, veçanërisht të votuesve për herë të parë, gadishmërinë për bashkëpunim me KQZ-në të Rektorateve të Universiteteve, Drejtorive Arsimore Rajonale, Drejtorive të shkollave të mesme, si dhe të organizatave të shoqërisë civile.

IV. VEPRIMTARIA E KQZ-SË PËR PËRGATITJEN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

4.1 Plani Orientues i Veprimeve

KQZ-ja, me nxjerrjen e dekretit të Presidentit të Republikës, nr.10928, datë 05.11.2018, për caktimin e datës 30 Qershor 2019, si datë për zhvillimin e Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore 2019, në kuadër të detyrimeve ligjore që ka, lidhur me organizimin, administrimin dhe kontrollin e procesit zgjedhor, miratoi një nga vendimet më të rëndësishme për procesin zgjedhor, vendimin për "Miratimin e Planit Orientues të Veprimeve".

Plani Orientues i Veprimeve është një kornizë udhëzuese për veprimet dhe aktet nënligjore, mbi të cilat do të mbështetet aktiviteti i mëtejshëm i KQZ-së. Plani Orientues i



Veprimeve, parashikon jo vetëm çdo akt nënligjor, të cilin KQZ-ja, duhet ta nxjerrë në zbatim të Kodit Zgjedhor (vendime, udhëzime, akte të thjeshta dhe akte normative), të cilat rregullojnë marrëdhënie të caktuara, si pasojë e ndryshimeve në ligj, ose ka lindur si nevojë nga praktikat e mëparshme zgjedhore, apo diktohet nga rekomandimet e OSBE/ODIHR-it.

Veprimet që parashikohen në këtë plan, burojnë nga detyrimet e përcaktuara nga dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe janë zbatimi i tyre në praktikë.

Detajimi i veprimeve konkrete dhe i afateve kohore, brenda të cilave këto veprime duhet të ndërmerren, duke iu referuar përcaktimeve të bëra në Kodin Zgjedhor, ndihmojnë KQZ-në të kontrollojë në çdo moment, ecurinë normale të procesit zgjedhor, ndihmojnë partitë politike, vëzhguesit e huaj dhe vendas të orientohen në realizimin e procedurave dhe njëkohësisht të kontrollojnë ecurinë e procesit dhe veprimtarinë e KQZ-së.

4.2 Aktet e miratuara në KQZ, gjatë vitit 2018, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Gjatë vitit raportues, vitit 2018, KQZ-ja për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 ka miratuar gjashtë vendime:

1. Me vendim nr.33, datë 19.11.2018 "Për miratimin e Planit Orientues të Veprimeve të KQZ-së për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019";
2. Me vendimin nr.35, datë 17.12.2018 "Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019";
3. Me vendimin nr. 37, datë 26.12.2018 "Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e KZAZ-ve, KQV-ve dhe anëtarëve të grupeve të numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019";
4. Me vendimin nr.38, datë 26.12.2018 "Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019";
5. Me vendimin nr.39, datë 26.12.2018 "Përdorimi i kamerave regjistruese dhe monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendin e numërimit të votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019";
6. Me vendimin nr.40, datë 26.12.2018 "Miratimi i strukturës, organikës dhe strukturën e pagave, të punonjësve me kohë jo të plotë pune, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, që do të rekrutohen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.



V. AKTIVITETE ME PARTNERË NDËRKOMBËTARË

5.1 Grupi Ndërkombëtarë i Punës për Zgjedhjet (EWG)

Në kuadër të transparencës dhe vendosjes së një bashkëpunimi permanent me organizmat ndërkombëtarë që operojnë në fushën e zgjedhjeve, KQZ është pjesë e Election Working Group (EWG), krijuar me iniciativën e Prezencës së OSBE , pjesë e të cilit janë ambasadat e shteteve anëtare të OSBE-së dhe Organizatat Ndërkombëtare në Shqipëri, të cilat kanë pjesë të aktivitetit të tyre edhe fushën zgjedhore.

Mbledhjet mujore të këtij grupi pune, të krijuar që nga vitin 2012, shërbejnë për informimin nga Kryetari i KQZ-së për veprimtarinë institucionale, problematikat dhe sfidat e ndeshura, koordinimin e projekteve dhe asistencës së partnerëve për trajtimin e tyre.

Gjatë vitit 2018 asistenca ka konsistuar në realizimin e tryezave teknike, disa aktiviteteve në nivel lokal dhe global, mbështetjes me ekspertizë të huaj si dhe organizimin e seminareve për ngritjen e kapaciteteve të administratës së KQZ-së.

Ndarja e eksperiencave pozitive në trajtimin e mjaft problematikave me të cilat përballen sot Trupat e Menaxhimit të Zgjedhjeve në rajon e më gjerë me synim shkëmbimin e përvojave dhe nxjerrjen e mësimave pozitive ka qenë dhe fokusi i aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2018 si vijon:

- **Vizitë studimore në Londër**, 31 janar - 3 shkurt, si pjesë e projektit të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar "Transparenca e Financimit të Zgjedhjeve në Shqipëri" (i cili gjithashtu mbështetet nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI) përmes financimit të USAID-it). Qëllimi ishte qw pjesëmarrësit të përfitonin nga përvoja e Mbretërisë së Bashkuar duke i dhene mundësinë për të shqyrtuar sistemin rregullator të financave politike në Mbretërinë e Bashkuar, përmes takimeve me zyrtarët e komisionit zgjedhor, akademikët dhe praktikuesit e tjerë.
- Vizitë studimore e dy ekspertëve zgjedhorë, përfaqësues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Qendrës për Trajnim të Vazhdueshëm Zgjedhor të Republikës së Moldavisë, me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Europës në Shqipëri. Gjatë vizitës tre ditore, ekspertët zgjedhorë së bashku me administratën e KQZ, u angazhuan për hartimin e një plani (një listë të aktiviteteve të mundshme) për të rritur efikasitetin e aktiviteteve të trajnimit dhe edukimit zgjedhor, me ose pa mbështetjen e komunitetit të donatorëve. Qëllimi tjetër synonte në hartimin e metodologjisë për planifikimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit, përfshirë trajnimin e trajnerëve, dhe për edukimin qytetar dhe zgjedhor të votuesve.
- **Vizitë studimore në Moldavi**, në Qendrën e Trajnimit Zgjedhor, 22 - 23 nëntor 2018, me mbështetje financiare të Zyrës së Këshillit të Evropës dhe OSBE-së.
- **KQZ-NDI, tryezë teknike për financimin e partive politike më 26 shkurt, 2018**



Komisioni Qendror u Zgjedhjeve me mbështetjen e Institutit Demokratik Amerikan (NDI), Ambasadës Britanike në Tiranë dhe USAID, organizuan një Tryezë teknike me Komisionerët dhe Administratën e KQZ-së, duke u fokusuar në rolin që KQZ duhet të luajë si rregullator i financimit të partive politike në Shqipëri. Komisionerët dhe Administrata e KQZ-së adresuan boshllëqet dhe dobësitë legjislative, si edhe shkëmbyen ide se si mund të përmirësohet kuadri ligjor, për të bërë të mundur transparencë sa më të plotë të financimit dhe shpenzimeve të partive politike. Gjetjet dhe konkluzionet e Tryezës u materializuan në një paketë rekomandimesh për financimin e partive politike.

- **Workshop, organizuar me mbështetjen e NDI, më 26 Shtator 2018**, i cili rriti aftësitë menaxhuese të administratës së KQZ-së në drejtim të veprimtarive strategjike dhe operacionale që duhet të ndërmerren në mënyrë që KQZ-ja të përmbushë rolin e vet në fushën e financave të partive në lidhje me zgjedhjet e 2019. Seanca përkornizën funksionale theksoi vlerën e politikave, procedurave, roleve dhe përgjegjësi, si mjet për të mbështetur rregullat efektive dhe promovimin e një kulture përmirësimi.
- Pjesëmarrje në **seminarin e mbështetur nga IFES për angazhimin e palëve të interesit të financave politike në Pragë, 6-7 dhjetor 2018**, ku prezantimet dhe angazhimet e administratës së KQZ Shqipëri në diskutime u vlerësuan shumë nga pjesëmarrësit e tjerë të institucioneve të mbikëqyrjes në Ballkanin Perëndimor.

Përfaqësimi i KQZ-së në aktivitetet e Mekanizmave Ndërkombëtar Zgjedhore

KQZ e Shqipërisë është një nga vendet themeluese dhe anëtare të ACEEEO-s (Shoqata e Zyrtareve Zgjedhore për Evropën). Konferenca vjetore është aktiviteti më i rëndësishëm i kësaj shoqate në bashkërendimin e projekteve dhe nismave zgjedhore si dhe në ngritjen profesionale të zyrtarëve zgjedhorë të shteteve pjesëmarrëse. KQZ është anëtare e Bordit Ekzekutiv, ku japën vlerësime lidhur me veprimtarinë e shoqatës si dhe të shfaqen opinionet lidhur me strategjitë e sukseshme të cilat do ndiqen në të ardhmen për administrimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme në të gjitha vendet anëtare përfshirë dhe Shqipërinë.

Gjithashtu vlen të theksohet dhe roli i KQZ-së si vend anëtar i A- WEB (Shoqata Botërore e Trupave Zgjedhore), në funksion të rritjes së imazhit institucional në planin rajonal por dhe me gjerë.

A- WEB ka mbështetur në mënyrë të vazhdueshme KQZ-në për rritjen e kompetencave të administrimit të zgjedhjeve. Gjatë 2018 përfaqësues të administratës së KQZ-së morën pjesë në dy programe trajnimi të rëndësishme për ngritje kapacitetesh në menaxhimin e zgjedhjeve, të zhvilluara në Sekretariatit e A-WEB në Republikën e Koresë:

- Programi me temë " Roli i edukimit qytetar dhe votuesve në pjesëmarrje politike", 10-20 prill 2018;
- Programi me temë "Promovimi i barazisë gjinore dhe pjesëmarrja e grave në politikë" me 5-15 nëntor, 2018.



5.2 Konferenca e 27-të vjetore e Shoqatë Europiane të Zyrtarëve Zgjedhor (ACEEEO)

KQZ mori pjesë në Konferencën e 27-të Vjetore dhe Takimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës së Zyrtarëve Zgjedhore Europiane (ACEEEO) në datat 5-7 Shtator në Vilnius të Lituanisë me temë "Garantimi i privatësisë së votuesve, sigurisë dhe integritetit"

VI - VERIFIKIMI I VETËDEKLARIMEVE TË FUNKSIONARËVE (DEKRIMINALIZIMI)

NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 'PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE PËR VITIN 2018

Ligji "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", u zbatua në të gjitha vendimmarrjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2018. Ligji përmban dispozita të cilat garantojnë integritetin e figurës së kandidatëve duke ndaluar kandidimin për t'u zgjedhur në funksione publike të deputetit, kryetarit të bashkisë ose anëtarit të këshillit bashkiak, të personave të cilat kanë kryer veprime ose mosveprime që përbëjnë vepër penale, sipas disa dispozitave të cituara në mënyrë shteruese në këtë ligj.

Për vitin 2018, në zbatim të ligjit të sipërcituar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar gjithësej, 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) verifikime për funksionarë publikë (deputetë kandidatë për deputetë, anëtar këshillash bashkiak dhe kandidat për anëtarë këshilli bashkiak), duke miratuar 27 vendime.

1.Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit për kandidatët për deputet gjatë plotësimit të vakancave për vitin 2018

Janë kryer verifikime për 4 (katër) kandidatë për Deputet, si rezultat i vakancave të krijuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

Kandidatët u verifikuan në përputhje me ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike" dhe Vendimin e Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", brenda afateve të përcaktuara.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit të përcaktuar, mbështetur në ligjin nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike", dhe Vendimin e Kuvendit nr.17/2016 për 4 (katër) kandidatët për deputet, kërkoi informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, përkatësisht për historinë e ndryshimit të gjenealiteteve dhe për gjendjen gjyqësore të tyre.



Nga verifikimi i dokumentacionit për 4 (katër) kandidatët për deputet (formularit të vetëdeklarimit, vërtetimit të gjendjes gjyqësore dhe të gjendjes civile), rezultoi se:

- 2 (dy) prej kandidatëve për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, kanë deklaruar në formularin e vetëdeklarimit, se kishte dënim me burgim me vendim të formës së prerë, që i përkisnin gjinisë mashkullore;
- 2 (dy) prej kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, nuk kishin të deklaruar asnjë të dhënë që përfshihet në kushtet e nenit 2, pika 1 dhe 2 të ligjit 138/2017, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për ndalimin e kandidimit.

Kandidatët të cilët rezultuan me dënime me burgim me vendim të formës së prerë, referuar nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk përfshiheshin në kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas këtij ligji.

2. Shqyrtime të rezultateve të verifikimeve të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2018

Në vitin 2018 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar 6 vendime "Verifikim i Thelluar", derguar në fund të vitit 2017 dhe në vijim Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë shprehur me vendimmarrje për 5 (pesë) raste. Nga këto vendime Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në 3 (tre) raste ka vendosur shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit për dy deputetë pas fillimit të ushtrimit të mandatit dhe ka shpallur faktin e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë për 1 (një) kandidat, për anëtar të këshillit bashkiak, ndërsa për 2 (dy) raste ka vendosur se ish/deputetët nuk përfshiheshin në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike". Në lidhje me shqyrtimin e rezultateve të verifikimit të thelluar për Kryetarin e Bashkisë Pogradec, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ende nuk është shprehur me vendimmarrje, për shkak se ka kërkuar, me vendim të ndërmjetëm, një informacion shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme, i cili nuk i është vënë ende në dispozicion nga ana e saj.

Më datë 26.12.2017 Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit të Integritetit, dërgoi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimet e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr.138/2015 për dy deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.

Sipas Prokurorisë së Përgjithshme të dy deputet nuk kishin deklaruar në formularin e vetëdeklarimit ndalime, hetime dhe përdorim të identitetit të rremë në shtetin Italian.

Subjektet nuk e kishin deklaruar këtë informacion, dhe pse kishin patur detyrimin ligjor për ta pasyruar në formularin e vetëdeklarimit dhe konkretisht në pikën 3 të formularit "A keni



qënë ndonjëherë në hetim apo gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?” dhe pikën 4 të formularit, “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale?”, i janë përgjigjur me “Jo” të dyja pyetjeve më sipër.

Në *KREUN III*, pika 3, gërma ç, të vendimit të Kuvendit nr.17/2016, thuhet se formulari (që plotësohet dhe firmoset nga subjektet vetëdeklarues) përmban një rubrikë që detyrimisht pasqyrohet se “...pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në të, sjell përjashtimin e menjëhershë dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik”.

Fakti që në formularin e vetëdeklarimit, nuk është pasqyruar asnjë e dhënë e përcjellë në lidhje me ndalimet dhe hetimet përkatëse në shtetin Italian, si dhe indetitetin e rremë të përdorur nga vetë ata, me të cilin është dyshuar se kanë konsumuar vepër penale, bën që subjekti të përfshihet në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik. Kjo pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga funksioni publik që mban.

KQZ, pasi shqyrtoi dokumentacionin në kuadër të zbatimit të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, informacion i ardhur nga institucioni i Prokurorisë krijoi bindjen se funksionarët kanë shkelur dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me zbatimin e drejtë, transparencën dhe frymën me të cilën funksionon ligji nr. 138/2015 “Për verifikimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”, dhe rregullimet e detajuara të parashikuara në vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar gërmës ç, pikës 3, Kreut III të Vendimit të Kuvendit nr.17/2016, ishin në kushtet për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me vendimet nr. 3, datë 05.01.2018 dhe nr. 4, datë 05.01.2018, vendosi për të dy rastet të shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit.

3.Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtar në këshillat bashkiak, gjatë procesit të plotësimit të vakancave të krijuara për vitin 2018

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 11 të ligjit nr.138/2015, ka verifikuar formularët e vetëdeklarimit për 68 (gjashtëdhjetë e tetë) kandidatë të listave shumëmemërore për këshillat bashkiak për plotësimin e vakancave të krijuara gjatë vitit 2018. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në ligjin nr.138/2015 dhe Vendimin e

Kuvendit nr.17/2016 kërkoi informacion për të gjithë kandidatët për Këshillat Bashkiak nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, përkatësisht për historinë e ndryshimit të gjenealiteteve dhe për gjendjen gjyqësore të tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit për 68 kandidatë (formularit të vetëdeklarimit, vërtetimit të gjendjes gjyqësore dhe të gjendjes civile), rezultoi se:



- 4 (katër) prej kandidatëve për Anëtarë në Këshillin Bashkiak, kanë deklaruar në formularin e vetëdeklarimit se kishin dënime me burgim me vendim të formës së prerë dhe 64 (gjashtëdhjetë e katër) prej kandidatëve për Anëtarë në Këshillin Bashkiak, nuk kishin të deklaruar asnjë të dhënë që përfshihet në kushtet e nenit 2, pika 1 dhe 2 të ligjit nr.138/2017, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për ndalimin e kandidimit. Kandidatët për Anëtarë në Këshillin Bashkiak të cilët rezultuan me dënime me burgim me vendim të formës së prerë pas verifikimeve të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve referuar dhe Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore të ardhur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve rezultuan se 1 (një) prej tyre përfshihej në fushën e ndalimit të ligjit nr.138/2015, ndaj të cilit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori vendim, "Të shpallë moszgjidhshmërinë si anëtarë në Këshillin Bashkiak", dhe 3 (tre) prej tyre nuk përfshiheshin në fushën e veprimit të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike".

- 1 (një) kandidat për anëtar në Këshillin Bashkiak ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit, se ndaj tij është caktuar masë e sigurisë personale "Garanci Pasurore", ndërsa pas verifikimit të ardhur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezultoi me statusin i "Pa dënuar". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimarrje vendosi, vazhdimin e procedurave për dhënie mandati nga Këshilli i Bashkisë.
- 21 (njëzetë e një) kandidatë për anëtarë në Këshillin Bashkiak, kanë deklaruar/rezultuar në formularin e vetëdeklarimit ndryshime në gjeneralitete;
- 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) kandidatëve u dha autorizimi për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit;
- 1 (një) kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, u konstatua në kushtet e moszgjidhshmërisë, pasi rezultoi se përfshihej në fushën e veprimit të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike";
- 1 (një) kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, u konstatua në kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë, si rezultat i shqyrtimit të vendimit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme.

